




INFORMACIONI I ÇRREGULLT: NDIKIMI I TIJ TEK INFORMIMI I QYTETARËVE



INFORMACIONI I ÇRREGULLT: NDIKIMI I TIJ TEK INFORMIMI I QYTETARËVE

Prishtinë, gusht 2022

Të drejtat e autorit ©2022. **Demokraci për Zhvillim (D4D)**.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pjesëve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Punim i përgatitur nga:

Instituti Demokraci për Zhvillim

–

Ky raport është publikuar nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në kuadër të projektit “Luftimi i keqinformimit dhe rikthimi i besimit të qytetarëve ndaj mediave”, që mbështetet nga NDI dhe USAID. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Institutit Demokraci për Zhvillim dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NDI dhe USAID.

Tabela e përmbajtjes

1	HYRJA	5
2	METODOLOGJIA	6
3	TË GJETURAT KRYESORE	12
4	KONKLuzionET	33
5	REKOMANDIMET	37
6	SHTOJCAT	40

Në vazhdim të monitorimit të portaleve online dhe rrjeteve sociale Instituti D4D prezanton publikimin e raportit për tremujorin e tretë ose raportin e katërt në përgjithësi. Në vitin e kaluar D4D, ka lanësuar *raportin e parë*,¹ ku është bërë monitorimi i fushatës zgjedhore dhe balotazhit në Kosovë, ndërsa në fillim të këtij viti është lanësuar *raporti i qerek vitit të parë (Q1)*², me monitorimin e portaleve online dhe rrjeteve sociale për muajt tetor-nëntor dhe dhjetor 2021. Ndërsa për këtë vit është bërë monitorimi i lajmeve për muajt janar-shkurt-mars me ç'rast është *raporti i dytë (Q2)* i lansuar nga Instituti D4D, ku janë monitoruar portalet online dhe rrjetet sociale. Derisa rrjedhimisht ky raport është i treti (Q3) në të cilin është duke punuar Instituti D4D, ku është bërë monitorimi i artikujve për periudhën prill - maj - qershor. Edhe në këtë raport janë përfshirë monitorimi i kategorive: ndasitë politike dhe gjuha e ashpër, Covid-19, ndikimi i jashtëm, gjykata speciale, dialogu Kosovë – Serbi, mizogjia dhe dhuna online ndaj grave.

Veçori e këtij raporti si në raportin e kaluar është analizimi i artikujve ku është raportuar për konfliktin Ukrainë-Rusi, lajme këto të cilat janë futur në kategorinë e ndikimit të jashtëm. Këto kategori të lajmeve janë analizuar në dy gjuhë; shqip dhe serbisht. Karakteristikë e këtij raporti, që ka dalur nga monitorimi i portaleve online dhe rrjeteve sociale janë artikujt me përmbajtje të *gjuhës së ashpër, gjuhës së urrejtjes* dhe lajme me *titull të ekzagjuar*. Raporti përmban konkluzione dhe rekomandime të cilat u drejtohen portaleve online, subjekteve politike, mediave si dhe qytetarëve.

¹ Fushata Zgjedhore në Llapë: A e cenonjë integritetin e zgjedhjeve çrregullimet e informacionit: e qasshme në: <https://d4d-ks.org/punimet/fushata-zgjedhore-ne-llape/>

² Portalet dhe Rrjetet Sociale në Llapë: Sa po ndikojnë çrregullimet e informacionit në jetën e qytetarëve, e qasshme në: https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2022/03/D4D_Q1report_SHQ_Final.pdf

2 | Metodologjia

Qëllimi i këtij raporti është identifikimi i lajmeve që përmbajnë çrregullime të informacionit të cilat me ose pa qëllim kanë ndikuar në keq informimin e qytetarëve, nxitjen e urrejtjes për individ ose grupe të ndryshme, si dhe familjarizimin e publikut me prezencën e çrregullimeve të informacionit dhe nevojën për vërtetim të lajmeve. Sikur në raportet paraprake edhe në këtë raport janë analizuar dhe pasqyruar artikujt dhe postimet me çrregullime të informacionit që publikohen dhe shpërndahen nëpër portalet online dhe rrjetet sociale në Kosovë në dy gjuhë: shqip dhe serbisht.

Instituti D4D, ka vazhduar me monitorimin e portaleve online dhe rrjeteve sociale. Ky raport ka përfshirë periudhën e monitorimit të artikujve në portale online dhe rrjete sociale për tre muaj, 1 prill deri më 30 qershor. Monitorimi është bërë duke përdorur dy platformave *MediaToolkit* dhe *Crowdtangel*. Monitorimi është bërë paralelisht edhe në mostrën në gjuhën shqipe dhe atë serbe. Në mostrën në gjuhën shqipe janë monitoruar 76 portale online, 203 faqe dhe 10 grupe në rrjetin social Facebook dhe 32 llogari në rrjetin social Twitter. Ndërsa në mostrën në gjuhën serbe janë monitoruar 55 portale online, 16 faqe dhe 1 grup në rrjetin social Facebook dhe 18 llogari në Twitter.

Tabela 1. Numri i portaleve online dhe rrjeteve sociale të monitoruara në këtë periudhë.

		Facebook		Portale Online	Llogari në Twitter
		Faqe	Grupe		
Mostra	SHQ	203	10	76	32
	SRB	16	1	55	18
Gjithsej		411			


Arsyeja pse janë përdorur dy platformat e lartë cekura është se të dy këto platforma bëjnë mbledhjen e të dhënave numerike. *MediaToolkit* ka bërë matjen e lexueshmërisë potenciale (reach) të artikujve dhe postimeve në portalet online dhe llogaritë në Twitter, *Crowdtangle* ka bërë matjen e ndërveprimeve (like, love, care, haha, wow, sad, angry, comment dhe share) në rrjetin social Facebook.

Duhet theksuar fakti që shumë portale online të Kosovës të cilat operojnë në gjuhën serbe marrin lajme direkt nga portalet online nga Serbia, një pjesë e konsiderueshme e portaleve të monitoruara në mostrën në gjuhën serbe janë portale që operojnë në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë. Gjithashtu tek mostra në gjuhën shqipe janë të përfshirë edhe disa portale që operojnë në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut. Në përmbajtje të këtij raporti do të përfshihen shembuj nga mostra në gjuhën shqipe dhe ajo serbe. Portalet online, faqet dhe grupet në Facebook dhe llogaritë në Twitter janë përzgjedhur duke marrë për bazë kriterin e numrit të ndjekësve që ato kanë pasur, bazuar në faktin që ato mund ta kenë ndikimin më të madh tek qytetarët dhe shpejtësia e shpërndarjes së informatës mund të jetë shumë herë më e lartë sesa ato që kanë numër më të vogël të ndjekësve. Po ashtu portalet online janë përzgjedhur në bazë të adresës së një portali, numër kontaktues të portalit, në bazë të asaj që një portal ka një kryeredaktor dhe redaktor. D4D ka ndërtuar një bazë të fjalëve kyçe në platformat me të është bërë monitorimi për të identifikuar më mirë lajmet të cilat ndërlidheshin këto kategori. Ato janë fjalë specifike për kategori janë formuar për t'u thelluar më shumë në kategoritë specifike.


Kategoritë në të cilat është fokusuar raporti janë: Ndikimi i jashtëm, ndasitë politike dhe gjuha e ashpër, Gjykata speciale, dialogu Kosovë – Serbi, mizogjinia dhe dhuna online ndaj grave si dhe Covid-19. Mirëpo çfarë e veçon këtë raport me raportet paraprake është fokusi më i madh në artikujt dhe postimet që raportuan për luftën Ukrainë - Rusi. Megjithatë, ky fakt nuk qëndron për të dyja mostrat, por vetëm për mostrën në gjuhën shqipe. Derisa në mostrën në gjuhën shqipe kemi ngritje të volumit të lajmeve të prodhuara mbi situatën në

Ukrainë, në mostrën në gjuhën serbe kemi situatë të ndryshme. Në mostrën në gjuhën shqipe, pra, për dallim me periudhën e raportit të qerekut të parë (Q1) të monitorimit, lajmet për këtë kategori të monitorimit u rritën për 162 përqind, ndërkaq krahasuar me periudhën paraprake të raportit të qerekut të dytë (Q2), ato u rritën për 62 përqind. Kjo ka ndikuar që në kategorinë e ndikimi të jashtëm të rritet numri i lajmeve dhe postimeve që prej fillimit të luftës në Ukrainë. Kjo tregon për një fokus të shtuar mbi luftën në mes të Ukrainës dhe Rusisë nga portalet online dhe rrjetet sociale në mostrën në gjuhën shqipe. Ndërkaq, në mostrën në gjuhën serbe, për dallim me raportin Q2, në këtë periudhë kemi rënje për 30% të volumit të lajmeve mbi luftën në Ukrainë të prodhuara në mediat serbe (*shih grafikën numër 2*).

Grafi 1. Numri i fjalëve kyçe të përdorura gjatë periudhës tetor 2021 - qershor 2022 sipas kategorisë në gjuhën shqipe. Burimi: Kalkulimi nga D4D.




Grafi 2. Numri i fjalëve qyqre të përdorura gjatë periudhës tetor 2021 - qershor 2022 sipas kategorisë në gjuhën serbe. Burimi: Kalkulimi nga D4D.



Në këto kategori është bërë monitorimi i çrregullimeve të informacionit ku përfshihen shpërndarja dhe publikimi, me ose pa qëllim, i informacioneve të pavërteta, të manipuluar, të ekzagjuruara apo që përmbajnë gjuhë të ashpër, seksiste dhe të urrejtjes. Për secilën nga kategoritë fillimisht janë filtruar artikujt dhe postimet me lexueshmëri potenciale më të madhe si një mënyrë për të matur ndikimin e këtyre artikujve tek lexuesit, ndërsa më pas është bërë analizimi i përmbajtjes së artikujve duke i klasifikuar ato në kategori të lajmeve që përmbajnë çrregullim të informacionit.

Grafi 3. Numri i lajmeve me fjalët kyçe të monitorimit rreth Covid-19.

Për dallim nga raportet tjera, në këtë periudhë, ashtu sikur në periudhën paraprake, gjatë monitorimit nuk janë gjetur narrativa të pavërteta që ndërlidhen me Covid-19, duke përfshirë këtu artikuj të portaleve online dhe rrjeteve sociale të cilat kanë shfaqur crregullime të informacionit. Kjo vërehet edhe në grafën 1, ku shihet numri i artikujve që kanë përmendur fjalët kyçe rreth Covid-19. Prandaj, në këtë raport nuk ka shembuj as në mostrën në gjuhën shqipe, as në gjuhën serbe.



Bazuar në këto kategori, Instituti D4D ka bërë edhe klasifikimin e artikujve me përmbajtje të çrregullt të informacionit, ku përqindja më e madhe e artikujve me çrregullim të informacionit në këtë raport në mostrën në gjuhën shqipe vie nga kategoria e ndikimit të jashtëm dhe ndasitë politike. Derisa në kategorinë e ndasive politike është përdorur, gjuhë e ashpër dhe ofenduese, tituj të ekzagjeruar, në kategorinë e ndikimit të jashtë kanë dominuar lajme të pavërteta dhe lajme konspirative. Ndërsa në mostrën në gjuhën serbe kategoria që ka pasur më së shumti artikuj me çrregullim të informacionit është ajo e ndasive politike dhe gjuhës së ashpër.

Gjatë procesit të monitorimit janë ruajtur informata të caktuara për shkak të vërtetësisë së të dhënave si dhe për shkak se disa artikuj apo postime ndonjëherë ndodh që të largohen pas postimit nga portalet ose grupet e caktuara. Me këtë rast kemi krijuar një bazë të të dhënave ku janë ruajtur materialet si në vijim:

- Screenshots; (Pamje të shkëputura nga ekrani)
- Të dhënat numerike si për shembull numri i lexuesve potencial, shpërndarja dhe ndërveprimet e tjera si pëlqimet, komentet dhe shpërndarja;
- Titujt e artikujve me fotografi, datë të postimit dhe emrin e publikuesit të lajmit.

Për më tepër, D4D ka bërë edhe një hap më tutje për të analizuar prezencën e grave që kanë pozita vendim-marrëse në politikë. D4D ka analizuar postimet në të cilat ato janë përmendur në platformën Facebook si dhe portretizimin e tyre, përfshirë këtu komentet e qytetarëve ndaj tyre. D4D ka marrë një mostër prej 20 postimeve që kanë gjeneruar më së shumti komente për gratë. D4D pastaj ka analizuar komentet e qytetarëve për këto gra. Nga gjithsej 7,307 komente të gjeneruara nga këto postime, D4D ka analizuar dhjetë përqind të tyre ose 729 komente dhe ka arritur të bëjë disa gjetje në lidhje me qasjen e komentuesve ndaj grave në politikë.

3 | Të gjeturat kryesore

Gjatë analizimit të 2,600 artikujve kemi vërejtur një numër të konsiderueshëm të artikujve dhe postimeve të cilat kanë pasur çrregullim të informacionit. Këtu përfshihen artikuj dhe postime të cilat kanë promovuar ndasitë politike, ofendimet, gjuhë të ashpër dhe seksiste, gjuhë të urrejtjes, fjalime, të nxjerra nga konteksti, artikuj ose postime me përmbajtje të pavërtetë, të manipuluar, të fabrikuar dhe tituj të ekzagjeruar. Marr parasysh që gjatë periudhës së monitorimit në raportin e kaluar janë monitoruar edhe lajme të cilat kanë të bëjnë me konfliktin Ukrainë – Rusi, edhe në këtë periudhë fokus i vecantë u është dhënë lajmeve të cilat kanë të bëjnë me këtë konflikt. Ajo çka është vërejtur në përgjithësi në këtë periudhë, përkundër që numri i lajmeve ka qenë mi vogël sesa në periudhën e Q2 por numër më të madh i lajmeve me përmbajtje të çrregullt të informacionit në kategorinë e ndasive politike dhe gjuhës së ashpër, luftës Ukrainë-Rusi si dhe mizogjinisë dhe dhunës online ndaj grave. Sidomos, narrativat që kanë qenë prezent në raportin e kaluar janë përsëritur por me fjalë të tjera dhe në të tjera formate.

Në aspektin e dhunës online ndaj grave është monitoruar edhe komentimi i audiencës digjitale në Facebook dhe është bërë matja e komenteve duke përcaktuar një mostër të komenteve për postimet që kanë pasur më së shumti ndërveprime. Rezultatet tregojnë për një gjuhë të ashpër të komentuesve ndaj grave në politikë.

Vlenë të theksohet që ndër ngjarjet që kanë prodhuar më së shumti çrregullim të informacionit është vendimi i Qeverisë së Kosovës lidhur me reciprocitetin në raport me letërnjoftimet e Serbisë. Ndërsa kur flasim për kategoritë tjera janë narrativat e kategorisë së ndasive politike më së shumti kanë dominuar artikujt që nuk janë të vërtetë dhe artikuj me gjuhë ofenduese, ku më të sulmuarit kanë qenë deputet të Kuvendit të Kosovës, Kryeministri i Kosovës, derisa sulmi me gjuhë ofenduese ndaj kryeministrit Albin Kurti ka dominuar edhe në mostrën në gjuhën serbe.

Ndërsa kur është bërë analizimi i artikujve të kategorisë së mizogjenisë dhe dhunës online ndaj grave nëse krahasojmë me raportin e kaluar, në këtë periudhë kjo kategori ka më shumë artikuj. Në mostrën në gjuhën shqipe kanë rezultuar artikuj, postime dhe komente ku janë sulmuar një grup i grave që mbajnë pozita politike. Disa prej tyre janë Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, Ministria e Jashtme Donika Gërvalla, dhe deputetet e Kuvendit të Kosovës si për shembull, Mimoza Kusari Lila, Ganimete Musliu, Blerta Deliu-Kodra, Ardiana Matoshi, e Fatmire Mulhaxha Kollçaku. Në këtë kategori po ashtu janë analizuar edhe komentet në rrjete sociale.

Gjatë analizimit të artikujve dhe postimeve lajmeve për muajt prill - qershor, në kategorinë e lajmeve për Gjykatën Speciale në mostrën në gjuhën shqipe kanë dominuar lajmet me titull të ekzagjeruar, të nxjerra jashtë kontekstit, gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë ofenduese. Kurse në mostrën në gjuhën serbe ku ka qenë e njëjtë mënyra e monitorimit janë gjetur 18 artikuj kanë qenë me çrregullim të informacionit. Më së shumti kanë dominuar lajmet me titull të ekzagjeruar dhe lajme e pa vërteta dhe konspiracion dhe gjuhë të urrejtjes, derisa më poshtë janë pasqyruar shembujt që kanë pasur më së shumti lexueshmëri potenciale dhe që kanë pasur më së shumti ndikim.

Gjithsej numri i artikujve dhe postimeve të analizuar me përmbajtje të çrregullimit të informacionit në të dyja mostrat ishte 2,600. Në këtë periudhë të monitorimit, në mostrën në gjuhën shqipe kanë qenë 1,300 artikuj dhe postime të analizuar ku prej tyre 81 prej tyre kanë pasur përmbajtje me çrregullime të informacionit, të cilat kanë gjeneruar 29,044 ndërverpime në rrjete sociale dhe 1,338,791 lexues potencial.

Ndërsa në mostrën në gjuhën serbe, po ashtu janë analizuar 1,300 artikuj dhe postime prej tyre 156 artikuj dhe postime kanë pasur përmbajtje të çrregullimit të informacionit të cilat kanë gjeneruar 172,758 ndërverpime në rrjete sociale dhe 8,012,771 lexues potencial. Derisa më poshtë janë paraqitur shembuj të artikujve dhe postimeve që përmbajnë çrregullim të informacionit në të dyja mostrat.

Edhe numri i ndërveprimeve në rrjetet sociale ka qenë më i madh se raportet Q1 dhe Q2. Numri i ndërveprimeve ka arritur në gati 200 mijë. Për herë të parë numri i ndërveprimeve në mostrën në gjuhën serbe është më i madh sesa ai në gjuhën shqipe. Këtu përshihet edhe krahasimi me raportin e zgjedhjeve dhe jo vetëm me raportet Q1 dhe Q2.

Në volumin e lajmeve të pavërteta ka po ashtu lëvizje serioze të numrave. Në këtë periudhë ka më shumë artikuj dhe postime me çrregullime të informacionit sesa dy periudhat e fundit të marra së bashku ($Q1 + Q2 = 215 / Q3=237$).

Lexueshmëria potenciale ka një rënje nga periudha paraprake, megjithatë mbetet në shifra të larta ($Q2=10,558,718 / Q2=9,351,562$).

Tabela 2. Raporti Prill - Maj - Qershor

	Shqip	Serbisht	Total
Artikuj dhe postime të analizuara	1,300	1,300	2,600
Ndërveprime në rrjete sociale	29,044	169,992	199,036
Artikuj dhe postime që përmbajnë çrregullime të informacionit	81	156	237
Njerëz që potencialisht kanë lexuar artikuj me çrregullime të informacionit	1,338,791	8,012,771	9,351,562

Ndikimi i jashtëm

Gjatë periudhës së monitorimit prill - qershor në analizimin e artikujve dhe postimeve në këtë kategori në mostrën në gjuhën shqipe ndikim më të madh patën lajmet që ndërlidheshin me luftën në Ukrainë. Narrativi që shqiptarët po luftojnë vullnetarisht në Ukrainë u vazhdoi edhe në këtë periudhë, ashtu sikur në periudhën paraprake. Pati edhe artikuj të tillë me tituj të ekzagjeruar e të paverifikuar lidhur me deklaratat e paqena rreth përfundimit të luftës në Ukrainë. Për më tepër, kishte edhe lajme të paverifikuara në lidhje me sëmundjen e Presidentit rus Vladimir Putin. Ndërkaq, në mostrën në gjuhën serbe pati lajme të pavërteta se Spanja e ka njohur Kosovën, që Britania e Madhe po e furnizon Kosovën me armë, dhe tituj të ekzagjeruar lidhur me intervenimet e NATO-s duke tentuar që të krijohet një ekuivalencë mes agresionit Rus dhe intervetimeve të NATO-s në Ballkan.

Gjithashtu në mostrën në gjuhën serbe kanë dominuar artikuj me përmbajtje jo të vërtetë dhe artikuj me titull të ekzagjeruar. Artikulli që ka pasur më së shumti lexueshmëri potenciale ka qenë deklarata e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i cili pretendon se qeveria e Kosovës është duke punuar në dëbimin e serbëve të cilët jetojnë në Kosovë.

Shembuj nga mostra në gjuhën shqipe

Artikulli me titullin, *“Rusia i jep fund luftës më 9 maj? Ministri Lavrov i jep fund dyshimeve”*, është lajm që është postuar në portale online. Ky lajm që përman çrregullim të informacionit pasi që është artikull me titull të nxjerrë jashtë kontekstit. Në artikull flitet për datën e festës së clirimit në luftën e dytë

Rusia i jep fund luftës më 9 Maj?
Ministri Lavrov i jep fund dyshimeve

Top Trend # May 2, 2022



botërore. Ky lajm ka pasur 78,046 lexues potencial dhe ka pasur 14 ndërveprime duke përfshirë 13 pëlqime dhe 1 koment.

Kryetari i Kievit Vitaly Klitschko është cituar jo drejtë në një portal që quhet “Le Canton 27” sikur të ketë thënë se falenderon Kosovën dhe shqiptarët për kontributin e tyre ushtarak dhe humanitar në luftën që po zhvillohet në Ukrainë. Megjithatë, ky lajmë është i pavërtetë për shkak se ai edhe publikisht në faqën e tij në Facebook ka mohuar të ketë thënë dicka të tillë për shqiptarët. Në lajm përmendet edhe një detaj ku



Klitschko: Faleminderit Kosovë, shqiptarë! Siç u çliroat ju nga Serbia, edhe ne do të çlirohemi nga Rusia

nënkuptohej që në ndihmën ushtarake ndaj Ukrainës ka edhe luftëtar “vullnetar”. Ky narrativ është i ngjashëm me narrativën e pavërtetë në raportin e kaluar të nxitur nga Ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergey Lavrov rreth pjesëmarrjes së luftetarëve nga Kosova në këtë luftë. Ky lajm u shpërnda nga dhjetë portale në Kosovë e Shqipëri dhe pati 49,322 lexues potencial, dhe 1,580 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 1,115 pëlqime, 432 komente dhe 33 shpërndarje në rrjete sociale.

Shembuj nga mostra në gjuhën serbe

Artikulli me titullin, “Rusia e ka poshtëruar tmerreshëm shtetin e rremë të Kosovës në Kombet e Bashkuara! Ana i dha Prishtinës një mësim si askush më parë”, është lajm që është prodhuar nga portalet online në Serbi, ku për bazë është marr deklarata e Ana Evstingnjeeva, Zëvendëspërfaqësuesja e përhershme e Rusisë në OKB. Ajo kishte

thënë se qëndrimi i Rusisë ndaj Kosovës mbetet i pa ndryshuar, ku ka përmendur edhe bombardimet e NATO-së që sipas saj kanë mbetur të vrarë shumë njerëz. Andaj ky lajm cilësohet si lajm me titull të ekzagjeruar. Ky lajm ka arritur tek 145,678 lexues potencial, dhe ka gjeneruar 35,878 ndërveprime prej tyre 32, 686 pëlqime, 2, 895 komente dhe 1, 315 shpërndarje dhe është riprodhuar në 5 portale tjera online në gjuhën serbe.

Arikulli me titullin, “Çmenduri e rrezikshme! Britania armatos shqiptarët për luftë: Xhonsn i ka dorëzuar armë shtetit të rremë të Kosovës të cilat i dërgon edhe në Ukrainë”, është lajm që është prodhuar nga portalet online serbe. Ky lajm është i rremë pasi që Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë raportimet e tilla i ka quajtur lajme të rreme të mediave serbe, se një avion ushtarak britanik i cili ateroi para disa ditësh në Aeroportin e Prishtinës barte armatim. Ky lajm ka pasur 19,919 lexues potencial, 211 ndërveprime prej tyre 94 pëlqime, 32 komente dhe 85 shpërndarje, dhe është riprodhuar në 3 portale online tjera në gjuhën serbe.



PHOTO: PRINTSCREEN YOUTUBE IZVOR: NAPPY BCC

RUSIJA JE NAJSTRAŠNIJE PONIZILA LAŽNU DRŽAVU KOSOVO U UJEDINJENIM NACIJAMA! Ana je očitala LEKCIJU Pristini kakvu nije niko do sada

21.04.2022.

Problemi 11. lista



11.04.2022. PULITRA

17.04.2022.

OPASNO LUDILO! BRITANIJA NAORUŽAVA ŠIPTARE ZA RAT! Džonson lažnoј državi Kosovo isporučio oružje koje šalje i Ukrajini!?!

Artikulli me titullin, *“Spanja e njej shtetin e rremë te Kosovës?! Hapja e një zyre në Prishtine, Madridi sapo e ka goditur rënd Serbinë”,* është lajm që është publikuar në portalet online serbe dhe po ashtu duke u bazuar në titull dhe përmbajtje është një lajm i pavërtet sepse Spanja nuk e ka njohur ende Pavarësinë e Kosovës dhe nuk ka hapur zyrë në Prishtinë. Ky lajm ka arritur tek 15,080 lexues potencial, 257 ndërveprime në rrjete sociale prej tyre 140 pelqime 116 komente dhe 1 shpërndarje.



ŠPANIJA PRIZNALA LAŽNU DRŽAVU KOSOVO?! Otvara kancelariju u Prištini, Madrid je upravo udario jak šamar Srbiji

Dialogu Kosovë - Serbi

Analizimi i artikujve për kategorinë Dialogu Kosovë - Serbi është monitoruar në mostrën në gjuhën serbe dhe për tre muajt e analizimit të lajmeve për këtë kategori D4D ka gjetur se 64 artikuj kanë pasur çrregullim të informacionit. Lajmet që kanë dominuar në këtë kategori janë ato që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, ofenduese dhe lajm jo të vërteta. Gjatë monitorimit të këtyre lajmeve vlen të theksohet se më së shpeshti është sulmuar kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Më së shumti kanë dominuar lajmet që burojnë nga deklaratat politike nga zyrtarë të Qeverisë së Serbisë të cilat përmbajnë gjysmë të vërteta e që nxitën edhe ndasi të karakterit etnik në Kosovë. Shumica ishin lajme që ishin vazhdimi e artikujve paraprak me qëllim të betonimit të tyre tek lexuesit në Kosovë dhe Serbi. Shpeshherë, lajmet që ndërlidheshin me implementimin e marrëveshjeve të nënshkruara në Bruksel u nxorrën jashtë kontekstit duke minuar kështu rëndësinë e dialogut Kosovë-Serbi. Shumica dërmuese e narrativave në mostrën në gjuhën serbe patën për qëllim që të ndjellin frikë përmes

hiperbollizimit të situatës në veri të Kosovës. Në disa raste, aksionet e policisë së Kosovës në veri u krahasuan me aksionin “Oluja(Stuhija)” që kishte ndodhur në luftën e Kroacisë.

Shembuj nga mostra në gjuhën shqipe

Artikulli me titullin, “*Reagon Petković: Albin Kurti kërcënoi me luftë dhe hakmarrje, përfaqësuesit ndërkombëtarë heshtin*”, është lajm që është prodhuar bazuar nga deklarata e drejtorit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković. Ky i fundit reagoi rreth vendimit të Qeverisë së Kosovës për reciprocitetin ndaj qytetarëve të Serbisë për letërnjoftimet.



Petar Petković - Foto: REL/ Zyrë për Kosovën

Reagon Petković: Albin Kurti kërcënoi me luftë dhe hakmarrje, përfaqësuesit ndërkombëtarë heshtin

Deklarata e Petkovićit se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti ka kërcënuar me luftë dhe hakmarrje nuk është i vërtetë pasi që në një mbledhje të mbajtur më 29 qershor Qeveria e Kosovës kishte vendosur që çdo qytetar i Serbisë që hyn në Kosovë me letërnjoftim të Serbisë duhet të pajiset në pikën kufitare me një fletë – deklarim, që përkohësisht e zëvendëson letërnjoftimin, njëjtë siç vepron Serbia me qytetarët e Kosovës. Ky artikull është lexuar potencialisht nga 50,611 lexues dhe ka pasur 1,389 ndërveprime, prej të cilave duke përfshirë, 937 pëlqime, 451 komente dhe një shpërndarje.

Artikulli me titullin, *“Vuçiq shkon më larg se Petkoviqi, thotë se Prishtina po planifikon sulm në veri deri më 1 tetor”*, është lajm i bazuar nga deklarata e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq i cili ka thënë se Prishtina është duke planifikuar sulm në veri përkatësisht në Mitrovicë deri më 1 tetor. Portalet online megjithatë nuk kanë

arritur ta theksojnë këtë deklaratë si të njëanshme dhe pavërtetë. Kjo deklaratë e presidentit Vuçiq vjen pas vendimit të Qeverisë së Kosovës, për mundësinë e regjistrimit të veturave me targat e qyteteve në Kosovë – të cilat i lëshojnë autoritetet e Serbisë – në RKS (Republika e Kosovës) andaj deklarata e Vuçiqit mund të cilësohet e njëanshme dhe jo e vërtetë pasi që Qeveria e Kosovës ka marr vetëm vendim lidhur me targat e veturave dhe nuk ka bërë planifikim për sulm. Ky artikull ka arritur potencialisht tek 18,020 lexues potencial, dhe ka gjeneruar 438 ndërveprime duke përfshirë 369 pëlqime, 66 komente dhe 3 shpërndarje.

Artikulli me titullin, *“Selakoviq për Kurtin: Hitleri i vogël i ballkanit që ëndërron ta pushtoj veriun e Kosovës”*, është artikull që citon deklaratën e Ministrit të Punëve të Jashtme të Serbisë, Nikola Selakoviq. Ai e ka quajtur Kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, Hitler i vogël i ballkanit në konetacion negativ duke e



Foto: REL/RFE

Vuçiq shkon më larg se Petkoviqi, thotë se Prishtina po planifikon sulm në veri deri më 1 tetor



Selakoviq për Kurtin: Hitleri i vogël ballkanik që ëndërron ta pushtojë veriun e Kosovës

cilësuar edhe si gënjeshtar. Andaj ky lajm në bazë të cilësimeve përmban çrregullim të informacionit dhe gjuhë të urrejtjes. Ky lajm ka arritur tek 13,953 lexues potencial, ka marr 666 ndërveprime duke përfshirë 307 pëlqime, 351 komente dhe 1 shpërndarje.

Shembuj nga mostra në gjuhën serbe

Artikulli me titullin *“Po planifikojnë sulm të përgjithshëm në veri të Kosovës, qëllimi i tyre është një “stuhi” e re”,* është lajm që ka ngjallur shumë debate në politikën e Serbisë . Ky lajm është prodhuar nga deklarata e presidentit të Serbisë Aleksandar Vuçiq në konferencën e mbajtur pas vendimit të qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e targave të Serbisë deri në

fund të shtatorit. Ai aludon se më së voni me 1 tetor Kosova po planifikon sulm të përgjithshëm në veri të Kosovës dhe vazhdon duke thënë se Serbia çdo herë është e gatshme për dialog derisa dikush asnjëherë nuk kanë qenë të gatshëm, por kanë pasur mbështetjen e fuqive perendimore. Ai shtoi se po kërkon nga autoritet e Kosovës që “të mos sulmojnë popullin serb” dhe se kryeministri i Kosovës Albin Kurti “ëndërron të jetë” në pozitën e presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky. Andaj ky lajm mund të cilësohet jo i vërtetë dhe i remë për shkak se Qeveria e Kosovës nuk ka dhënë paralajmërime të tilla por ka marr vendime për reciprocitet të targave. Ky lajm ka pasur 1,119,258 lexues potencial, 25,834 ndërveprime prej tyre 13,404 pëlqime, 11,426 komente dhe 1,004 shpërndarje dhe është riprodhuar 13 portale online tjera serbe.

Vučić: Planiraju opšti napad na sever Kosova, cilj im je nova „Oluja“

VESTI | Autor: 111 Beograd, Stefan Mijaj | 29 Jun 2022 10:56 - 30 Jun 2022 11:50 | 662 komentare

Publi | [f](#) [t](#) [v](#) [s](#)



Artikulli ime titullit, *“Po përgatitet masakër ndaj serbëve në Kosovë? Ekspertët: Kemi planin, nuk do të qëndrojmë në Beograd dhe të shikojmë se si na dhunohen gratë dhe na vriten fëmijët”*, është deklarata e shkëputur nga një debat televiziv nga disa opinionistë serbë. Kjo deklarata ka rrjedhur pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për reciprocitetin e targave në një debat televiziv në Serbi, ku analistët pretendojnë se me vendimin e qeverisë së Kosovës për reciprocitet është duke u përgatitur masakër ndaj serbëve. Sipas kësaj deklarate mund të thuhet se është lajm i pavërtetë dhe i ekzagjeruar. Ky lajm ka arritur tek 47,491 lexues potencial, dhe ka gjeneruar 769 ndërveprime, 336 pëlqime, 380 komente dhe 53 shpërndarje.

Artikulli me titullin, *“Vuçiq: Serbët në Kosovë e Metohi nën goditje të fortë – duan t’i largojnë ose ti detyrojnë të pajtohen me pavaresinë”*, është lajm i prodhuar duke shkëputurdeklaratat e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, deklarata kjo thënë pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për zbatimin e marrëveshjes së Brukselit për reciprocitetin. Ai ka thënë se populli jonë në Kosovë e Metohi e sidomos



USJANGJI

**SPREMA SE POGROM SRBA NA KOSOVI?!
Stručnjaci: Imamo PLAN, nećemo sedeti
u Beogradu i gledati kako nam
SILUJU ŽENE i UBIJAJU DECU**

NASLOVNA NAJNOVIJE VESTI KOSOVSKA ŠTAMPA DIALOG GRAD INTE

Ustavni sud: Bitovani primeniti Akt o Srbima

Vučić: Srbi na KIM pod snažnim udarom – hoće da ih oteraju ili nateraju da se pomire sa nezavisnošću

Izvor: KofSav - 30 aprila 2022, 13:47



ata në veri çdo ditë përjetojnë një goditje ekonomike, politike dhe çdo goditje tjetër dita ditës bëhet më të fortë, duke thënë gjithashtu se do ta shfrytëzojnë rastin e Ukrainës për t'i dëbuar serbët ose i detyrojnë ata të punojnë atë që është e pamundur. Andaj ky lajm mund të cilësohet lajm që përmabn gjuhë të ekzagjeruar dhe lajm me përmbajtjetë njëanshme. Ky lajm ka pasur 21,232 lexues potencial, dhe 968 ndërveprime, prej të cilave 661 pëlqime, 295 komente dhe 12 shpërndarje.

Mizogjia dhe dhuna online ndaj grave


Gjatë kësaj periudhe pati më shumë artikuj dhe postime që sulmuan gratë krahasuar me periudhën paraprake. Më së shumti kanë dominuar lajmet me gjuhë ofenduese, gjuhë të urrejtjes dhe deklarata me seksiste ndaj grave në politikë. Më saktësisht më të sulmuarat kanë qenë Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, Ministrja e Punëve të Jashtme Donika Gërvalla, dhe Ddeputetëtja e Kuvendit të Kosovës, Mimoza Kusari-Lila, Ganimete Musliu, Blerta Deliu-Kodra, Ardiana Matoshi, e Fatmire Mulhaxha Kollçaku.

Në mostrën në gjuhën shqipe, gjatë monitorimit D4D ka gjetur 17 artikuj që kanë çrregullim të informacionit ndërsa në mostrën në gjuhën serbe gjatë analizimit dhe monitorimit të portaleve dhe mediave sociale nuk është hasur në ndonjë lajm që ka pasur çrregullim të informacionit. Derisa më poshtë janë pasqyruar shembuj që kanë pasur më së shumti lexues potencial dhe me më së shumti ndikim tek publiku.

D4D ka shkuar edhe një hap më tutje për të analizuar edhe komentet në Facebook për të parë reagimet e qytetarëve. Kështu, janë analizuar 729 komente në Facebook për të cilat portalet online kishin nxjerrë pyetje për publikun lidhur me mendimin e këtyre të fundit për gratë në politikë. Nga 729 komente të analizuara janë gjetur se shumica e komenteve për gratë janë pozitive. Rreth 74 përqind e komentuesve kanë mendim pozitiv për gratë në politikë (shih grafën 5). Megjithatë,


një numër i konsiderueshëm i tyre kanë qasje ofenduese ndaj grave ose mos-pajtime politike me to. Sidoqoftë, shumica e komenteve negative kishin të bënin me dukjen e grave, me ofendime të rënda, gjuhë të urrejtes, dhe gjuhë seksiste. Thënë këtë, 15 përqind e komentuesve kanë përdorur këtë gjuhë, derisa 11 përqind e komenteve janë kundërshtime të ashpra politike ndaj grave. Këtu përfshihen mospajtime rreth mandatit të tyre – shpesh duke aluduar që ato nuk e kanë aftësinë politike dhe nuk e meritojnë vendin në parlament, disa duke shprehur haptas kundërshtimet e tyre mbi baza politike ose bindjeve partiake. Në kuptimin e strukturës së komentuesve, 77 nga gjithsej 176 komentues janë gra. Pra, 43 përqind, ose gati gjysma e komenteve negative ose kritikës për gratë në politikë vije nga gratë (shih grafikën 6).

Grafi 4. Komentet në Facebook sipas kategorisë së komenteve. *Burimi: Kalkulim nga D4D*



Grafi 5. Komentet në Facebook sipas kategorisë së gjinisë së komentuesve. *Burimi: Kalkulimi nga D4D*

Komente negative në bazë të gjinisë



Shembuj nga mostra në gjuhën shqipe

Artikulli me titullin: “Baton Haxhiu: Zëdhënësja e Përjetshme e Pushtetit, fliste edhe për të brendshmet e saj”, është lajm që është prodhur nga një opinion i shkruar nga gazetari kosovar, Baton Haxhiu. Në opinionin e tij Haxhiu ka përdorur gjuhë seksiste dhe mizogjinike ndaj deputetës, Mimoza Kusari Lila, duke e paragjykuar dhe shprehur gjuhë ofenduese

ndaj saj duke e cilësuar atë si të *dobët* dhe të *verbër* si dhe duke komentuar deklaratat e saj për veshjet. Për më tepër, rrugëtimin e saj politik me parti politike e quan me tog-fjalëshin “martesat e saj të



njëpasnjëshme”. Ky artikull ka arritur tek 1,968 lexues potencial, ka pasur 382 ndërveprime duke përfshirë 318 pëlqime, 57 komente dhe 7 shpërndarje.

Ndasitë politike dhe gjuha e ashpër

Ndasitë politike përmes gjuhës së ashpër, kritikave të pabaza, narrativave të pavërteta vazhduan edhe në këtë periudhë. Ato u bazuan në ngjarjet kryesore që kanë ndodhur gjatë kësaj peirudhe dhe u nxitën si nga gazetarë, po ashtu edhe nga vet politikanët. Për dallim me periudhat e kaluara, përplasja politike ka kulmuar edhe në aspektin privat. Një status i bërë në Facebook vite më parë ku Ministri Hekuran Murati kishte ofenduar rëndë Ushtrinë Clirimtare të Kosovës u bë arenë e përleshjeve të ashpra politike. Kjo ka bërë që Dardan Molliqaj nga PSD të rrjedhë informacione private të Ministrit duke bërë thirrje publike ndaj qytetarëve që të ti përdorin këto informata që të kërkojnë dorëheqje nga ai.

Për më tepër, gjuha e rëndë, shpeshherë me fjalor banal vazhdon të jetë prezente nëpër diskursat publike të politikanëve, derisa në anën tjetër gazetarët shpeshherë kanë dështuar të dënojnë përdorimin e kësaj gjuhe kur kanë raportuar për këto deklarata.

Disa gazetarë kanë postuar shkrime të tyre të njëanshme nëpër platformat e tyre në rrjetet sociale duke kritikuar politikanët të caktuar dhe Kryeministrin e Kosovës për mos përmbushje të premtive, dhe duke i atribuar atij disa dështime që nuk lidhen direkt me qeverinë.

Shembuj nga mostra në gjuhën shqipe

Artikulli me titullin: *“Nga mbylle gojën”, Albulena Haxhiu deri në “a jau q***robt” si eskaloi Abelard Tahiri*, është lajmë që është prodhuar nga deklarata e deputetit, Abelard Tahiri i cili është shef i grupit

parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Ai në seancën e thirrur për shkarkimin e Martin Berishajt, Ambasador i Kosovës në Kroaci u përfshi në debat me ministren e drejtësisë, Albulena Haxhiu. Gjatë debatit Tahiri u dëgjua edhe duke i thënë *mbylle gojën* ministres Haxhiu derisa gjatë fjalimit, ai kishte harruar mikrofonin nderur

dhe dëgjohet duke sharë, ofendim ky drejtuar Grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV). Andaj kjo deklaratë e deputeti Tahiri përmban gjuhë ofenduese dhe urrejtjes ndaj gruas në këtë rast ministres Haxhiu. Ky artikull ka arritur tek 2,473 lexues potencial, dhe ka pasur 82 ndërveprime, duke përfshirë 32 pëlqime, 44 komente dhe 6 shpërndarje.

Artikulli me titullin: *“Kërkoj korigjim të territorit në Çakorr, Haradinajt i vjen një reagim i ashpër: Kjo është kurvëri politike!”*, është artikull që citon deklaratën e profesorit Sulejman Mehazi i cili e quajti kurvëri politike kërkesën e deputeti të Kuvendit të Kosovës, Ramush Haradinaj për korigjimin e kufirit Kosovë - Mali i Zi. Andaj kjo deklaratë

mund të cilësohet çrregullim i informacionit pasi që është përdorur gjuhë e ashpër dhe banale ndaj Haradinajt. Ky artikull ka arritur tek

Nga “mbylle gojën”, Albulena Haxhiut deri në “a jau q*** robt”, si eskaloj Abeldar Tahiri



Kërkoj korigjim të territorit në Çakorr, Haradinajt i vjen një reagim i ashpër: Kjo është kurvëri politike!

NGA: A.M. MË: 5 PRILL 2022 NË ORA: 22:52



54,359 lexues potencial, 1,066 ndërveprime duke përfshirë 428 pëlqime, 582 komente dhe 56 shpërndarje.

Ka qenë një status i vitit 2016 në Facebook i Ministrit të Financave Hekuran Murati i cili është vënë në pah edhe njëherë nga portalet online në Kosovë. Statusi i Muratit përmbanë gjuhë të ashpër duke kritikuar thellë angazhimin e popullit të Kosovës drejtë lirisë. Kjo për shkak se me anë të këtij statusi, Murati bënë krahasim mes ushtarëve të UÇK-së dhe mercenarëve duke relativizuar krejtësisht

kontributin e të parëve. Ky artikull u shpërnda edhe në të paktën tre portale të tjera dhe ngjalli mjaftë reagime ne rrjetet sociale duke arritur tek 27,300 lexues potencial, dhe 2,342 ndërveprime, prej të cilave 320 reagime të ashpra, 1,268 komente, 604 pëlqime dhe 150 shpërndarje në rrjete sociale.

Murati në 2016 për veteranët: Me pas angazhu mercenar na kish dal ma lirë lufta, as faleminderit s'kishim pas nevojë me iu thanë

29/06/2022 | 19:20



Shembuj nga mostra në gjuhën serbe

Artikulli me titullin: *“Shteti i rremë i Kosovës sapo ka marrë goditjen më të fortë! Këto fjalë Prishtina asesi nuk ka dashur t’i dëgjoj”,* është lajm që është prodhuar nga takimi në mes të Rijadom Malkijem, Ministrit të Jashtëm të Palestinës dhe Ministres së Punëve të Jashtme të Kosovës Donika Gërvalla. Portalet online pas

këtij takimi Kosovën e kanë quajtur shtet i rremë, duke u bazuar në këtë titull ky lajm mund të cilësohet jo i vërtet për shkak se Kosova është shtet i pavarur që nga viti 2008. Ky artikull ka arritur tek 65,433 lexues potencial, 2,318 ndërveprime në rrjetet sociale prej tyre 1510 pëlqime, 716 komente dhe 92 shpërndarje dhe është riprodhuar në 2 portale tjera online.



Gjykata Speciale

Në mostrën në gjuhën shqipe pati narrativa të paverifikuar, sic është rasti i Baton Haxhiut si bashkëpunëtor i shefit të sigurimit Shtetor Jovica Stanishiq, dhe narrativa që Hashim Thaci dhe Skënder Hyseni i përkasin botës së krimit.

Në mostrën në gjuhën serbe narrativat ishin më përmbajtje të pavërtetë. Ato varionin prej raportimit të deklaratave të pavërteta të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë rreth trafikimit me organe dhe armë ku sipas tyre perëndimi kishte dhënë bekimin që ky trafikim të lulëzonte. Narrativa të tjerë që krejtësisht të pavërteta se lufta e UKC-së finançohej nga shitje e organeve të serbëve e deri te

konspiracioni për vrasjen e raportuesit Zvicran në Këshillin e Evropës Dick Marty.

Shembuj nga mostra në gjuhën shqipe

Artikulli me lajmin, *“Hyseni së bashku me Thaçin i përkasin botës së krimit / Analisti nga Amerika: Ndoshta Skënderi e di pse Hashimi është në burg?”*, është lajm që është prodhuar nga një postim i analistit Binak Maxharraj, i cili Skender Hysenin dhe Hashim Thaçin i quan njerëz të cilët i përkasin botës së krimit. Ky cilësim që i është bërë Hysenit dhe Thaçit përmban

çrregullim të informacionit, duke u cilësuar si deklaratë e pabazuar, pasi që nuk bazohet në të dhëna, dhe për të cilat Gjykata Speciale nuk ka dhënë ende një verdiktë përfundimtar dhe ashtu ku lajm mund të cilësohet si artikull me përmbajtje të gjuhës se urrejtjes ndaj Hysenit dhe Thaçit. Ky lajm ka arritur tek 13,635 lexues potencial, dhe ka gjeneruar 709 ndërveprime në rrjete sociale, prej të cilave 523 pëlqime, 136 komente dhe 50 shpërndarje.

“Hyseni së bashku me Thaçin i përkasin botës së krimit”/ Analisti nga Amerika: Ndoshta Skënderi e di pse Hashimi është në burg!?”



Shembuj nga mostra në gjuhën serbe

Artikulli me titullin, *“Lobi shqiptar shërbimeve serbe po u paketon vrasjen e Dick Marty: Aksion skandaloz në Zvicër, ka reaguuar edhe agjensioni i informacioneve të sigurisë”*, është lajm i dal pas një interviste të dhënë të Dick Martit për një media zvicrane ku Marty pohoi se prej 16 muajsh është nën mbrojtje të lartë policore, për shkak të kërcenimeve me jetë, te cilat siq ka thënë i vijnë nga “qarqe të caktuara të shërbimeve sekrete serbe”, të cilat sipas tij, “u kanë këkuar varsësve të paguar nga nëntoka që ta likuidonin”, për të fajësuar më

pas "shqiptarët nga Kosova. Andaj ky lajm mund të cilësohet si lajm me titull të ekzagjeruar dhe lajm me përmbajtje jo të vërtetë. Ky lajm ka 12, 622 lexues potencial, 322 ndërveprime, 147 pëlqime, 135 komente dhe 39 shperndarje dhe është riprodhuar nga 2 portale tjera në gjuhën serbe.



Artikulli me titullin, "E keni bombarduar Jugosllavinë dhe e keni monitoruar trafikimin e organeve në Kosovë! Zaharova ua mbyll gojën brutalisht britanikëve!", është lajm që është prodhuar nga deklarata e Maria Zaharova, zëdhënëse e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë, e cila ka reaguar për deklaratën e Ministres së Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, Liz Traz e cila gjatë vizitës së saj në Ballkan ka folur për influencën katastrofike të Rusisë në Ballkan.



Zarahova në reagimin e saj ka përmendur edhe Kosovën duke thënë se Londra mbikëqyri trafikimin e organeve në Kosovë dhe Metohi dhe kontrabandën e shumë gjërave në rajon, përfshirë edhe kontrabandimin e armëve. Andaj kjo deklaratë mund të cilësohet si lajm jo i vërtetë për shkak se për këtë deklaratë nuk ka prova e as verdikt të gjykatës. Ky lajm ka arritur te 297,572 lexues potencial, dhe ka gjeneruar 18, 398 ndërveprime në rrjete

sociale duke përfshirë 1,6101 pëlqime, 1,349 komente dhe 948 shpërndarje.

Artikulli me titullin, “Shtëpia e verdhë: “Si u financua UÇK-ja terroriste nga shitja e organeve të serbëve të rrëmbyer në Kosovë?”, është një lajm i publikuar në portalin online serb ‘Kurir’. Përmbajtja e lajmit ka të bëjë me një paralajmërim për një mbajtje të një debati ku do të diskutohet për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, ku


thuhet se krimet e UÇK-së janë bërë në baza etnike duke bërë transplantimin e organeve në një shtëpi të verdhë në Shqipëri, duke u bazuar në një raport të ish-senatorit Dick Marty. Mirëpo ky lajm mund të cilësohet si lajm që me përmbajtje të çrregullt pasi që të gjitha këto pretendime janë të pa verifikuara. Ky lajm ka arritur tek 21,200 njerëz potencial, dhe ka gjeneruar 22 ndërveprime në rrjete sociale dhe është riprodhuar në 2 portale tjera online në gjuhën serbe.




4 | Konkluzionet

Gjatë kësaj periudhe (Q3) numri i lexuesve anipse ka rënë për më shumë se një milion, ai vazhdon të mbetet mjaft lartë krahasuar me periudhën e Q1 që ishte raporti i parë pas zgjedhjeve lokale të vitit të kaluar (shih grafi 7). Kësaj radhe për dallim me periudhën e kaluar pati shumë më shumë lexues potencial në mostrën në gjuhën serbe sesa në gjuhën shqipe. Kjo për shkak të prezencës së madhe të lajmeve që ndërlidheshin me situatën në veri të Kosovës dhe lajmeve të ekzagjeruara dhe të pavërteta në portalet online në serbi të cilat pastaj u reflektuan edhe në Kosovë.

Grafi 6. Totali i lexuesve potencial të artikujve dhe postimeve me përmbajtje të çrregullt. *Burimi: Kalkulimi nga D4D*



Grafi 7. Totali i lexuesve potencial të artikujve dhe postimeve me përmbajtje të çrregullt sipas mostrës



Gjatë periudhës së monitorimit prill - qershor, gjatë analizimit të artikujve me çrregullim të informacionit është vërejtur prezencë e lajmeve që kanë të bëjnë me ndasitë politike dhe gjuhë të ashpër, ndikimin e jashtëm, luftën në Ukrainë dhe reflektimin e gabuar të saj në disa raste nëpër portalet në Kosovë dhe Serbi.


Për më tepër, një komponent me rëndësi në kategorinë e ndikimit të jashtëm është aftësia e dezinformatave për të nxitur urrejtje dhe ndasi politike në Kosovë. Në të dyja mostrat, me thekst të veçantë në mostrën në gjuhën serbe është tentuar të bëhet një ndërlidhje e padrejtë e agresionit rus në Ukrainë dhe interventimit të NATO-s në Kosovë si dhe deformim i thellë i fakteve rreth veprimeve të Qeverisë së Kosovës në veri. Këto kanë dëmtuar seriozisht komunikimin e dy qeverive në dialogun Kosovë - Serbi. T Kanë vazhduar të jenë prezent narrativa të pavërteta rreth përfshirjes së vullnetarëve nga Kosova në luftën në Ukrainë, narrative ky që ishte prezent edhe në raportin Q2,

dhe narrativa të pavërteta që Britania ishte përfshirë në transportin e armëve në Kosovë.

Në kuptimin e ndasive politike në Kosovë, tema kryesore vazhdon të jetë përdorimi i gjuhës së ashpër, urrejtjes dhe ofendimeve të ndërsjella mes politikanëve, analistëve dhe deputetëve - shpesh duke përdorur edhe fjalë banale. Fakte të nxjerrura jashtë kontekstit kanë bërë që këto akuza ndaj njëri-tjetrit të nxisin përqarje edhe tek populli bazuar në të dhënat e analizuar në këtë raport, më saktësisht në bazë të ndërveprimeve të njerëzve në rrjetet sociale. Sic shihet në grafikën 9, numri i ndërveprimeve nga audiencia online vetëm se po shtohet. Ndërveprimet janë rritur për 20 përqind nga raporti i kaluar (Q2).

Në aspektin e gjuhës së rëndë dhe ofenduese ndaj grave, D4D ka gjetur një numër të konsiderueshëm të komenteve online në platformën Facebook. Nga 729 komente të analizuar, D4D ka gjetur se 176 janë komente negative ose më shumë se 25 përqind e tyre ishin komente negative ndaj grave. Vlenë të theksohet që gati gjysma e komenteve negative për gratë vijnë nga gratë.

Grafi 8. Ndërveprimet në rrjete sociale nga audiencia online sipas periudhave kohore.
Burimi: Kalkulimi nga D4D



Një aspekt i rëndësishëm është rritja e artikujve dhe postimeve me përmbajtje të pavërtetë në këtë periudhë. Kjo tregon se ngjarjet e vecanta asociohen me rritje të këtyre lajmeve. Për shembull, rasti i veprimeve të Kosovës në implementimin e reciprocitetit ka shkaktuar mori lajmesh të pavërteta. Kjo dëshmohet edhe me numrin e lexuesve potencial dhe ragimeve të tyre online sidomos në mostrën në gjuhën serbe (shih grafikën 8). Në këtë periudhë pati më shumë artikuj dhe postime në rrjete sociale më shumë se dy periudhat e kaluara të marra së bashku ose 237 sosh. Në dy periudhat e kaluara në total kishte 215. Për më tepër, kjo dëshmohet edhe me numrin e lajmeve të pavërteta në mostrën në gjuhën serbe në këtë periudhë. Në këtë mostër ka më shumë artikuj dhe postime me përmbajtje të pavërtetë sesa periudhat e tjera (Q1 dhe Q2) të marra së bashku. Dhe për herë të parë më shumë sesa ato në shqip.

5 | Rekomandimet

Mediat është e rëndësishme t'i informojnë në mënyrë të drejtë dhe të kontribuojnë në integritet të zgjedhjeve por edhe situatës politike në vend përgjithësisht. Në anën tjetër, edhe partitë politike dhe përfaqësuesit e tyre duhet të zgjedhin gjuhën e komunikimit dhe të shmangin përdorimin e termave ofendues.

Rekomandimet për media

Të verifikohen të gjitha faktet para publikimit të lajmit - sidomos ato që ripublikohen dhe ato që kanë të bëjnë me lajmet që vijnë nga agjencitë e huaja të lajmeve;

Të mos promovohen ndasitë politike dhe gjuha e urrejtjes

Të raportohet me kujdes dhe përgjegjshmëri për mizogjininë;

Të implementohet praktika e raportimit të ndjeshëm gjinor;

Gjuha seksiste dhe gjuha e urrejtjes të cilësohen si të tilla në raportimet për to;

Të filtrohen komentet në rrjetet sociale të mediave, duke i larguar ato që përmbajnë gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë seksiste

Të përmbahen nga përdorimin i titujve të ekzagjeruar që kanë për qëllim gjenerimin e klikimeve

Të gjithë artikujt e sponsorizuar në media të shkruara të kenë një shënim se janë të sponsorizuar nga subjekti politik apo kandidati i subjektit amë;

Media të bëjë të qartë dhe të denoj gjuhën ofenduese ndaj grave në politike;

Portalet të bëjnë verifikimin e fakteve dhe të mos bien pre e mashtrimeve që bëhen në media të huaja - sidomos në ato që vijnë nga Rusia dhe aleatet e saj;

Portalet të angazhohen në citimin e raporteve të gjykates speciale dhe të mos krijojn tituj të ekzagjeruar;

Portalet online si dhe llojet e tjera të mediave (TV, gazeta, radio), të përdorin mënyra të filtrimit për komentet në lajmet që ata shpërndajnë në rrjetet e tyre sociale e që janë me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes, gjuhë seksiste dhe ofenduese;

Vendosja e emrit të autorit/gazetarit që ka bërë lajmin, nëse nuk është e mundur vendosen vetëm inicialet e autorit/gazetarit, kjo për arsye të identifikimit të portalit që e kopjon lajmin nga burimet e pa cituara.

Rekomandimet për Subjektet Politike

Të mos promovohen ndasitë politike, që ndikojnë në nxitjen e urrejtjes tek qytetarët;

Të mos përdoret gjuha seksiste kundrejt grave;

Partitë politike dhe liderët politikë duhet të përmbahen nga gjuha e ashpër, e urrejtjes dhe mizogjinike;

Partitë politike dhe liderët politikë nuk duhet të përfshihen në kampanja dezinformuese;

Partitë politike duhet t'i bëjnë publike shpenzimet për fushatë elektorale në rrjete sociale;

Partite politike të ndertojnë rregullore të brendshme me ç'rast ndërmerren masa dicitpinore ndaj anetarëve që përfshihen në fushata dezinformuese”;

Rekomandimet për qytetarët

Të kontrollohet dhe verifikohet, burimi i informacionit, autori, data e publikimit dhe linku i portalit

Të verifikohet vërtetësia e lajmit para se të shpërndahet në rrjete sociale

Të lexohen artikujt në tërësi dhe të mos shpërndahen informata bazuar vetëm në titujt e artikujve

Të përmbahen nga gjuha e urrejtjes dhe gjuha seksiste në komentime në rrjete sociale

Personat që preken në shpifjet dhe ofendimet e natyrave të ndryshme të raportojnë ato tek Keshilli i Mediave të Shkruara;

6 | Shtojcat

Definicionet e terminologjisë mbi informacionet me përmbajtje të çrregullta

Termi	Definicioni
Çrregullimet e informacionit	Çrregullimet e informacionit janë shpërndarja dhe publikimi, me ose pa qëllim, i informacioneve të pavërteta, të manipuluar, të ekzagjëruara apo që përmbajnë gjuhë të ashpër, seksiste dhe të urrejtjes.
Lexueshmëri potenciale	Lexueshmëria potenciale do të thotë se sa njerëz potencialisht e kanë lexuar artikullin nga artikujt në portalet online. Të dhënat për secilin artikull janë gjeneruar nga platformat me të cilat kemi bërë monitorimin.
Ndërveprimet	Ndërveprimet përfshinë të gjitha veprimet e lexuesve në një postim në Facebook apo në Twitter, ku pëfshihen pëlqimet, komentet, shpërndarja e artikullit apo reagime të tjera si i lumtur, i mërzitur, i nervozuar dhe i habitur.
Dezinformata	Informacion i paverifikueshëm i rremë ose mashtrues, i krijuar, paraqitur dhe shpërndarë për përfitime ekonomike ose për të mashtruar ndërkombëtarisht publikun, i cili mund të shkaktojë dëm publik, kërcënimet ndaj proceseve demokratike politike dhe të politikëbërjes, si dhe të së mirës publike.

Gjuhë e urrejtjes	Fjalimi ose shkrimi abuziv ose kërcënues që shpreh paragjykim ndaj një grupi të caktuar
Mizogjinia	Urrejtja, neveria ose paragjykimi ndaj grave
Dhuna online	Përdorimi i pajisjeve ose shërbimeve dixhitale në internet për t'u përfshirë në aktivitete që rezultojnë në vetëlëndim fizik, psikologjik, emocional ose i shkaktojnë dëm një personi tjetër.
Tituj të ekzagjëruar	Titull i krijuar për t'i bërë lexuesit të dëshirojnë të klikojnë në një hiperlink, veçanërisht kur lidhja çon në përmbajtje me vlerë ose interes të dyshimtë.

Lista e shkurtesave

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKR	Aleanca Kosova e Re
D4D	Demokraci për zhvillim
FSK	Forcat e Sigurisë së Kosovës
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LVV	Lëvizja Vetëvendosje
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
ROSU	Njësia Speciale Operative e Policisë së Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
ShBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

—

659(496.51)(047)

Informacioni i çrregullt: ndikimi i tij tek informimi i qytetarëve / punim i përgatitur nga Instituti Demokraci për Zhvillim. - Prishtinë : Instituti Demokraci për Zhvillim, 2022. - 44 f. : ilustr. ; 28 cm.

Masmedia -- Informacion elektronik -- Raporte

ISBN 978-9951-823-34-0

Aleph [000103761]

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë. Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndërsektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik. Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org



ISBN 978-9951-823-34-0



9 789951 823340